

Ardiana Qamili, PhD¹

UDC: 341.645.2(492)
327.5(497.7:495):342.228]:341.645.2(492)

**GJYKATA NDËRKOMBËTARE E DREJTËSISË DHE REPUBLIKA
E MAQEDONISË SË VERIUT**

**МЕЃУНАРОДНИОТ СУД НА ПРАВДАТА И РЕПУБЛИКА
СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**INTERNATIONAL COURT OF JUSTICE AND THE REPUBLIC
OF NORTH MACEDONIA**

Abstract

The International Court of Justice (ICJ) is a sui generic court which was established or took its legal basis from the UN Charter and by its statute which is also part of the UN Charter.

ICJ from the moment of its establishment has gone through a dynamic process of development, at certain periods its activity has been somewhat almost paralyzed or very poor, and in some periods, it has been very active.

The reasons that led to the establishment of the ICJ have been numerous, and the innovation that has brought to international jurisdiction The International Court of Justice in all these decisions of existence and activity of doing so great.

A case of special research interest for this research is also the history of the establishment of the ICJ, its competencies, authorities the manner of electing judges, the adoption of decisions, etc.

Another purpose of this paper is to shed light on the most important aspects of the legal, institutional system and how the ICJ operates.

¹ Autorja është studente e Ciklit të tretë në Universitetin Shtetëror të Tetovës, Fakulteti Juridik, drejtimi marrëdhëniet ndërkombëtare dhe historia e diplomacisë.

The dispute of the Republic of North Macedonia with the Republic of Greece over the issue of the constitutional name of the Republic of North Macedonia, presented before the International Court of Justice, will also be analyzed in detail.

Keywords: International Court of Justice, Republic of North Macedonia, Name Dispute of the Republic of North Macedonia and the Hellenic Republic, Decisions of the International Court of Justice

Historiku i krijimit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

Fillimisht duhet të theksohet, që themelimi i Gjykatave të Përhershme Ndërkombëtare është i lidhur me themelimin e organizatave politike ndërkombëtare. Organi i gjashtë kryesor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara është Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, me qendër në Hagë. Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë është pjesë integrale e Kartës dhe është thuajse identik me Statutin e mëparshëm të Gjykatës së Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare, krijuar nga Lidhja e Kombeve.²

Të gjitha shtetet, të cilat vlerësojnë që kontesti i tyre mund dhe duhet të zgjidhet nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe të cilët besojnë në parimin e saj të objektivitetit dhe të paanshmërisë, respektivisht në rendin ndërkombëtar juridik në përgjithësi, ndërmarrin rrugën gjyqësore të zgjidhjes së atij kontesti. Karakteristike për zgjidhjen gjyqësore të kontesteve është ekzistimi i institucionit gjyqësor, i cili i ushtron kompetencat e tij në bazë të normave të së drejtës materiale relevante për kontestin që është parashtruar.³ Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë e ka historinë e saj. Ajo është e lidhur ngushtë me historinë e OKB-së, organ i së cilës ajo është. Vijat e përgjithshme paraprake të organizimit dhe të funksionimit të Gjykatës Ndërkombëtare u hodhën pa mbaruar akoma lufta, në vjeshtë të vitit 1944, në një mbledhje të mbajtur në Dumberton-Oks afër Uashingtonit, me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Fuqive të Mëdha të Koalicionit antifashist. Në fund të fundit, në Konferencën e San Franciskos u vendos që të krijohej një gjykatë ndërkombëtare e re. Kështu, krahas aprovimit të Kartës së

² Drita M. Fazlia, Zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, Tetovë, 2014, f. 105.

³ Lisen Bashkurti, Mbi të drejtën ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, Geer, 2006, f. 120.

OKB-së në tërësi, në San Francisko u aprovua edhe projekti i statutit të Gjykatës Ndërkombëtare.⁴

Përbërja e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, zgjedhja e gjykatësve dhe organizimi i GJND-së

Si organi kryesor gjyqësor i Kombeve të Bashkuara, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë përbëhet nga pesëmbëdhjetë gjyqtarë të pavarur të cilët zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme dhe Këshilli i Sigurimit.⁵ Nuk lejohen dy gjykatës me të njëjtin nacionalitet. Gjykata duhet të përfaqësojë si e vetme sistemin ligjor kryesor të botës. Gjykatësit shërbejnë nëntë vjet, me skadim të afatit të shërbimit të pesë gjykatësve në çdo tre vjet. Nuk ka limite kohore për të shërbyer për gjykatësit nëse ata rizgjidhen. Në rast të çështjeve që lidhen me një shtet të caktuar, i cili nuk ka anëtar në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë, ai shtet mund të caktojë një gjykatës për atë rast specifik. Në këtë rast, përfaqësuesi i shtetit në fjalë merr pjesë në proces me të drejtë vote si anëtarët e përhershëm të Gjykatës.⁶ Gjykata zgjedh kryetarin dhe nënkryetarin për një periudhë trevjeçare: këta mund të rizgjidhen. Gjykata emëron sekretarin e Gjykatës dhe cakton dispozita për emërimin e nëpunësve të tjerë, sipas nevojës.⁷ Gjykata detyrat kryesore në përbërjen e plotë, mirëpo për kuorum mjaftojnë nëntë gjyqtarë. Gjykata mund të formojë një e më shumë këshilla gjyqësore, që përbëhen nga së paku tre gjyqtarë, për zgjidhjen e ndonjë lloji të lëndëve, si edhe trupin gjyqësor prej pesë gjyqtarëve, i cili vendos me procedurë të shkurtër kur këtë e kërkojnë palët. Vendimet e këtyre trupave e kanë vlerën sikur t'i kishte marrë vetë Gjykata.⁸

Procedura e kontestit para GJND-së

Statuti i GJND-së përmban normat e përgjithshme lidhur me procedurën, e cila në detaje është e paraparë në Rregulloren e Gjykatës, e cila rregullore është bazuar në nenin 30 të Statutit. Raste që trajtohen

⁴ Arben Puto, E Drejta Ndërkombëtare Publike. Botimi i dymbëdhjetë. Shtyshkronja "Guttenberg", Tiranë, 2010, f. 443.

⁵ Charles W. Kegley Jr, Politikat botërore-tendenca dhe transformimi, Ufo University, press, publikimi i XII, Tiranë, f. 161.

⁶ Lisen Bashkurti, Mbi të drejtën ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, Geer, 2006, f. 120.

⁷ Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare, Qendra e informacionit e Kombeve të Bashkuara, Shtëpia Botuese 8 Nëntori, Tiranë, 1987, (Statuti i GJND-së), neni 21.

⁸ Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2003, f. 436.

nga Gjykata vendosen me shumicë vote nga gjykatësit anëtarë pjesëmarrës. Kuorumi është nëntë gjykatës. Në rast specifik, Kryetari i Gjykatës ka votën përcaktuese. Vetëm shtetet mund të sjellin raste në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë dhe jo subjekte të tjera.⁹ Lënda e mosmarrëveshjes i paraqitet gjykatës me komunikimin ose me padinë e njëjës palë. Pas kësaj, Sekretari i Gjykatës, me ndërmjetësimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i njofton për këtë të gjithë të interesuarit dhe anëtarët e Kombeve të Bashkuara, e shtetet e tjera, që janë të autorizuar të paraqiten para gjyqit. Procedura ka dy faza: fazën me shkrim dhe fazën verbale. Gjuhë zyrtare të Gjykatës janë frëngjishtja dhe anglishtja. Palët derisa të zgjatë procedura, mund të arrijnë ujdin ose të heqin dorë nga vazhdimi i procedurës. Heqja dorë mund të bëhet nga paditësi në çdo moment përderisa pala kundërshtarë të mos ketë ndërmarrë ndonjë veprim, ose edhe më marrëveshjen e palëve nëse procedura ka filluar mbi bazë të kompromisit. Marrëveshja është e nevojshme edhe atëherë kur procedura ka filluar me padi, pas së cilës pala tjetër ka ndërmarrë ndonjë veprim.¹⁰ Përveç këtyre që thamë, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë jep edhe rekomandime, këshilla dhe opinione me karakter ligjor. Me gjithë mangësitë që ka treguar, sërish pranohet ndërkombëtarisht që Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka luajtur një rol të rëndësishëm për zhvillimin e sistemit të së drejtës ndërkombëtare.¹¹

Kompetenca e GJND-së për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare

Sipas Statutit, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë ka dy lloje të kompetencave edhe atë:

- a) kompetenca për të zgjidhur mosmarrëveshjet,
- b) kompetenca për të dhënë mendim konsultativë.

Si mosmarrëveshje juridike që mund të zgjidhen nga Gjykata, Statuti i numëron mosmarrëveshjet që kanë si subjekt:

- interpretimi i një marrëveshjeje ndërkombëtare
- çdo çështje nga e drejta ndërkombëtare
- ekzistenca e ndonjë fakti i cili, nëse vërtetohet, do të përbënte shkelje të ndonjë detyrimi ndërkombëtar

⁹ Lisen Bashkurti, Mbi të drejtën ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, Geer, 2006, f. 121.

¹⁰ Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Universiteti i Prishtinës, 2003, f. 440.

¹¹ Lisen Bashkurti, Mbi të drejtën ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, Geer, 2006, f. 121.

➤ natyrën ose shumën e kompensimit që pason për shkak të shkeljes së një detyrimit ndërkombëtar.¹²

Gjykata ka për detyrë të shqyrtojë vetëm konfliktet midis shteteve. Ajo nuk merr në shqyrtim konfliktet midis shteteve dhe personave privatë dhe aq më pak ato midis personave privatë. Bile edhe konfliktet midis shteteve Gjykata është kompetente t'i marrë në shqyrtim vetëm me pëlqimin e palëve në grindje. Nga kjo del se juridiksioni i Gjykatës Ndërkombëtare është fakultativ. Kjo do të thotë se shtetet nuk mund të detyrohen të dalin përpara Gjykatës Ndërkombëtare për çfarëdo çështje. Kusht paraprak i domosdoshëm për këtë është gatishmëria e tyre.¹³

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, përpos zgjidhjes së mosmarrëveshjeve midis shteteve, me kërkesën e çdo organi ose institucioni të autorizuar nga Karta e Kombeve të Bashkuara, mund të japë mendim konsultativ (*advisory opinions*) mbi çdo çështje juridike. Sipas natyrës së vet juridike, mendimet konsultative të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, përfaqësojnë shprehjen e mendimit të Gjykatës për këtë ose atë çështje juridike të së drejtës ndërkombëtare. Ato s'kanë forcë detyruese, por vetëm përfaqësojnë rekomandime.¹⁴ Asambleja e Përgjithshme ose Këshilli i Sigurimit mund të këshillohen me Gjykatën Ndërkombëtare për çfarëdo çështje juridike. Organet e tjera të Kombeve të Bashkuara dhe institucionet e specializuara, që në çfarëdo kohe autorizohen për këtë qëllim nga Asambleja e Përgjithshme, kanë gjithashtu të drejtë të këshillohen me Gjykatën për çështje juridike që lindin brenda kuadrit të veprimtarisë së tyre.¹⁵

Vendimet e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

Pas dëgjimit të agjentëve, këshilltarëve dhe avokatëve kryetari deklaron se shqyrtimi ka marrë fund. Më pastaj trupi gjyqësor tërhiqet për të marrë vendimin.¹⁶ Vendimet sillen me shumicë votash të gjykatësve. Në raste kur gjatë sjelljes së vendimit votat janë të ndara, atëherë

¹² Lubomir D, Fërçkovski, Vasil Tupurkovski, Vladimir Ortakovski, E drejta ndërkombëtare publike, Shkup, 1995, f. 308.

¹³ Arben Puto, E drejta ndërkombëtare publike. Botimi i dymbëdhjetë. Shtypshkronja "Guttenberg", 2010, f. 446.

¹⁴ Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2003, f. 442.

¹⁵ Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare, Qendra e informacionit e Kombeve të Bashkuara, Shtëpia Botuese 8 Nëntori, Tiranë, 1987, (Statuti i GJND-së), neni 96.

¹⁶ Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2003, f. 441.

vota vendimtare është vota e kryetarit ose e atij që zëvendëson kryetarin. Nëse aktvendimi nuk paraqet në tërësi ose në veçanti vlerësimin e gjykatësve, atëherë secili gjykatës ka të drejtë të jep vlerësimin e vet dhe ai vlerësim ose mendim ta shoqërojë vendimin e gjykatës. Vendimi i GJND-së përmban edhe arsyetimet mbi të cilat edhe e kanë sjellë vendimin.

Vendimi i Gjykatës ka fuqi të detyrueshme vetëm për palët dhe vetëm për atë kontest të caktuar.¹⁷ Vendimi është përfundimtar dhe i paapelueshëm. Në rast se ka kundërshtim, për sa i përket kuptimit dhe shtrirjes së vendimit, Gjykatës i takon të bëjë interpretimin e tij me kërkesën e cilësdo palë.¹⁸ Rishikimi i vendimit mund t'i kërkohej Gjykatës vetëm në rast se zbulohet një fakt që mund të ushtrojë ndikim vendimtar dhe që Gjykata dhe pala që kërkon rishikimin e vendimit nuk e njihin para dhënies së vendimit dhe, në rast se për këtë të fundit, mosnjohja nuk vjen nga pakujdesia. Procedura e rishikimit hapet me vendim të Gjykatës që konstaton shprehimisht ekzistencën e një fakti të ri, që pranon se ky i fundit është i një natyre të tillë që të bëhet shkas për rishikimin e vendimit dhe që deklaron se, për këto arsye, kërkesa e rishikimit është e pranueshme. Gjykata mund të pranojë procedurën e rishikimit të vendimit vetëm pas zbatimit paraprak të tij. Kërkesa e rishikimit të vendimit duhet të paraqitet jo më vonë se brenda gjashtë muajve pas zbulimit të faktit të ri. Nuk mund të paraqitet asnjë kërkesë për rishikimin e vendimit pasi kanë kaluar dhjetë vjet që nga data e dhënies së vendimit.¹⁹

Veprimtaria e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë

Në periudhën midis 1946 deri 1988, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë vendosi për 60 mosmarrëveshje ndërshtetërore dhe 20 kërkesa për opinione këshilluese që është modeste në raport me veprimtarinë e ish-Gjykatës së Përhershme. Në të njëjtën kohë, në raport me numrin në rritje të shteteve në bashkësinë ndërkombëtare, numri i deklaratave të pranimit të juridiksionit të detyrueshëm të Gjykatës tregon një rënie të vazhdueshme. Veprimtaria relativisht modeste e Gjykatës bazohet kryesisht në mosbesimin e ish-shteteve socialiste dhe shteteve të tjera

¹⁷ Drita M. Fazlia, Zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, Tetovë, 2014, f. 131.

¹⁸ Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare, Qendra e informacionit e Kombeve të Bashkuara, Shtëpia Botuese 8 Nëntori, Tiranë, 1987, (Statuti i GJND-së), neni 60.

¹⁹ Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare, Qendra e informacionit e Kombeve të Bashkuara, Shtëpia Botuese 8 Nëntori, Tiranë, 1987, (Statuti i GJND-së), neni 61.

në të, në ngurtësinë dhe kohëzgjatjen e procedurave të saj dhe preferencën nga shtetet e metodave më fleksibile për zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve. Nga ana tjetër, që nga fillimi i viteve 1980, numri i mosmarrëveshjeve të paraqitura para Gjykatës është rritur ndjeshëm, falë futjes së një procedure më fleksibile për zgjidhjen e mosmarrëveshjes në marrëdhëniet ndërkombëtare.²⁰ Rasti i parë që ka zgjidhur Gjykata pas Luftës së Dytë Botërore, ka qenë rasti i Kanalit të Korfuzit ose rasti anglo-shqiptar (1949).²¹ Numri në rënie i kazuseve gjyqësore dhe i kërkesave për konkluzione konsultative, si dhe numri i kufizuar i shteteve që kanë pranuar juridiksionin e detyrueshëm të Gjykatës sipas nenin 36 (2) të Statutit është një tregues i qartë i faktit se Gjykata Ndërkombëtare luan gjithsesi një rol anësor në marrëdhëniet ndërkombëtare. Në mënyrë të veçantë nuk mund të mos shprehet keqardhje dhe zhgënjim për faktin se Gjykata Ndërkombëtare ka luajtur një rol krejt të parëndësishëm në çështjet e ruajtjes së paqes dhe sigurimit ndërkombëtar. Ka disa arsye për këtë. Në radhë të parë, është vetë karakteri i sistemit të sotëm që bazohet në gati 200 shtete sovraane, që ruajnë me xhelozë pavarësinë e tyre dhe kanë frikë se mos cenohen sadopak statusi ose interesat e tyre kur bien në dorë të të tjerëve. Kjo shpjegon se shtetet nuk preferojnë që kontradiktat që implikojnë interesat themelore t'ia besojnë një organi që nuk dihet se ç'anë do të marrë. Veç asaj, dhe kjo ndikon më shumë, shpesh ndodh që shtetet, edhe kur kanë një vendim të Gjykatës në favor të tyre, nuk janë të sigurt se ky vendim do të zbatohet, sepse pala tjetër mund të refuzojë zbatimin. Kjo është arsyeja që shumë konflikte u besohen procedurave diplomatike ose arbitrazhit në sajë të fleksibilitetit të këtyre mjeteve përballë Gjykatës Ndërkombëtare.²² Të gjitha këto flasin për një krizë serioze që po përjeton Gjykata.

Mirëpo, megjithëkëtë, Gjykata, me vendimet e veta, ka dhënë kontribut për sqarimin e së drejtës dhe për zhvillimin e saj, është bërë "një mjet i rëndësishëm për përcaktimin e së drejtës", si edhe ka kontribuar për uljen e tensionit në zona të konfliktit. Pikërisht për këto arsye, gjatë viteve vendimet e Gjykatës citoheshin nga ministritë, nga gjykatat

²⁰ Lubomir D, Fërçkovski, Vasil Tupurkovski, Vladimir Ortakovski, E drejta ndërkombëtare publike, Shkup, 1995, f. 308-314.

²¹ Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2003, f. 443.

²² Arben Puto, E drejta ndërkombëtare publike. Botimi i dymbëdhjetë. Shtypshkronja "Gutenberg", Tiranë, 2010, f. 443.

e nga juristët, sa herë që këta donin të provonin ekzistimin e ndonjë rregulle ndërkombëtare.²³

Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe Republika e Maqedonisë së Veriut

Republika e Maqedonisë në vitin 2011, pas serisë së ofendimeve që iu bënë në integrimin euroatlantik, parashtrori padi kundër Republikës së Greqisë pranë Gjykatës në Hagë. Lënda e padisë është shkelja e Marrëveshjes së Përkohshme nga viti 1995, me çka RM-së iu vendos pengesa për marrjen e ftesës për anëtarësim në NATO në Samitin e Bukureshtit, dhe njëkohësisht pengesë për anëtarësim në BE. Synimin për anëtarësim në NATO, Republika e Maqedonisë e ka konfirmua më 23.12.1993, kur Parlamenti i RM-së mori vendim për anëtarësim në Organizatën Veri-Atlantike - NATO. Me padinë, RM-ja kërkoi nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë t'i urdhërojë Greqisë respektimin e detyrimeve të cilat dalin nga Marrëveshja e Përkohshme, e cila ka fuqi detyruese juridike, që me fjalë të tjera do të thotë vlerësimin real të proceseve euroatlantike, e jo mbi baza politike. Këtu duhet të theksoj që RM-ja ka parashtruar padi vetëm për shkelje të Marrëveshjes së Përkohshme nga ana e Greqisë, Marrëveshje të cilën të dy palët e kanë nënshkruar më 13 shtator 1995 dhe që e krijoi bazën juridike për normalizimin e marrëdhënieve midis dy shteteve, por jo edhe për zgjidhjen e kontestit ndërkombëtarë përmes GjND-së.

RM-ja në asnjë rast dhe në asnjë deklaratë pranë GjND-së nuk ka pohuar që çështja kontestuese e parashtruar pranë saj është shqyrtimi i procesit dhe vendimit për anëtarësim në NATO në atë periudhë. Pra, çështja e vendimit të NATO-s nuk është çështje kontestuese e parashtruar para GjND-së. Në pajtim me këtë, kompetenca e Gjykatës është që të zgjidh vetëm për padi konkrete të parashtruar, e jo të përzihet në procesin e zgjidhjes diplomatike të kontestit që është në vijim. Nga ana tjetër Greqia i arsyeton veprimet e saj duke u bazuar në nenin 11 (1) nga Marrëveshja e Përkohshme, që nga ana tjetër RM-ja i lejon përdorimin e emrit kushtetues gjatë anëtarësimit në organizatat ndërkombëtare. Me këtë refuzohet argumenti kryesor i Greqisë në raport me padinë kundër veprimit të saj kundër Marrëveshjes së Përkohshme.

²³ Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2003, f. 445.

Në këtë situatë RM-ja ka pozitë shumë më të volitshme, pasi të gjitha argumentet juridike janë në anën e saj, edhe pse në Marrëveshjen e Përkohshme ka hapësirë që një palë pjesërisht ose tërësisht të tërhiqet pas periudhës prej shtatë viteve, pasi ta njoftojë me shkrim palën tjetër për qëndrimin zyrtar.²⁴

Më 5 dhjetor 2011 Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë solli gjykim, ku vërtetoi se Greqia, duke kundërshtuar pranimin e vendit në NATO, e shkeli obligimin e vet nga neni 11, paragrafi 11 nga Marrëveshja e Përkohshme. Gjykata më tej konstatoi se duhet të supozohet vullneti i saj i mirë si shtet, sjellja që është shpallur si e gabuar nga ana e Gjykatës, të mos përsëritet në të ardhmen. Megjithatë, gjykimi nuk kishte ndikim të mjaftueshëm në anëtarësimin e RM-së në NATO.²⁵ Edhe pse GJND-ja i dha të drejtë RM-së, fakti që aktvendimi i GJND-së nuk ka fuqi detyruese, bëri që RM-ja për arsye të situatave gjeo-politike, ekonomike dhe presioneve të brendshme dhe të jashtme, përmes Marrëveshjes së Prespës të nënshkruar më 25 janar 2018, përfundimisht të ndryshojë emrin e saj në “Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV)”. Marrëveshja e Prespës hyri në fuqi me 12 shkurt 2019.²⁶ Pritshmëritë ishin që pas ndryshimit të emrit RMV-ja t’i bashkohet NATO-s the BE-së. Pas ratifikimit të të gjitha 29 shteteve, Maqedonia e Veriut zyrtarisht u bë anëtare e NATO-s me 27 mars 2020²⁷ Deri më tani komuniteti ndërkombëtar nuk mbajti premtimin e inkuadrimit të Maqedonisë së Veriut në BU.

Conclusions

Establishment of the International Court of Justice marks an important step in modernizing the international system, respectively enrichment with this international institution for the international system represents its further perfectionism.

During its activity, the International Court of Justice has managed in most cases to defend the fundamental democratic principles and values of the modern international system.

²⁴ Drita M. Fazlia, Organizatat ndërkombëtare, Tetovë, 2014, f. 106.

²⁵ <https://www.mfa.gov.mk/sq/page/1504/çështja-e-emrit>

²⁶ <https://www.un.org/sg/en/content/sg/statement/2019-02-13/statement-attributable-the-spokesman-for-the-secretary-general-prespa-agreement>

²⁷ https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_174589.htm

Taking stock of the work of the UN International Court of Justice, it must be said that it has not taken its place and has not played the role in resolving international conflicts that it should have had. Indeed, from the year of its founding (1946) until The International Court of Justice has recently dealt with a limited number of inter-state cases and this also applies to consultative conclusions. In the first phase after the end of World War II and in the 50s of the XX century, the International Court of Justice has had a large volume of work. But further, especially after 1962, the activity of the International Court of Justice has dropped significantly. We provided the case of North Macedonia as a case study.

It can be competently concluded that just like everything that was influenced by antagonisms during the Cold War period, the activity of the ICJ was subject to these antagonisms.

However, after the end of the Cold War, the facts show that the role of the UN is growing more and more and, in this context, the role of the ICJ in the upcoming period will be more important.

Recensentë:

Prof. Dr. Afrim Osmani

Prof. Dr. Afet Mamuti

Literatura:

1. Drita M. Fazlia, Organizatat ndërkombëtare, Tetovë, 2014
2. Drita M. Fazlia, Zgjidhja paqësore e mosmarrëveshjeve ndërkombëtare, Tetovë, 2014
3. Lisen Bashkurti, Mbi të drejtën ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, Geer, 2006
4. Arben Puto, E drejta ndërkombëtare publike. Botimi i dymbëdhjetë. Shtypshkronja "Guttenberg", ISBN 978-99943-0-160-7. Tiranë, 2010
5. Charles W. Kegley, Jr, Politikrat botërore - tendenca dhe transformimi, Ufo University press, publikimi i XII, Tiranë
6. Karta e Kombeve të Bashkuara dhe Statuti i Gjykatës Ndërkombëtare, Qendra e informacionit e Kombeve të Bashkuara, Shtëpia Botuese 8 Nëntori, Tiranë, 1987
7. Lubomir D. Fërçkoski, Vasil Tupurkovski, Vladimir Ortakovski, E drejta ndërkombëtare publike, Shkup, 1995, f, 308

8. Zejnullah Gruda, E drejta ndërkombëtare publike, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë, 2003

9. Burim interneti: <https://www.mfa.gov.mk/sq/page/1504/çështja-e-emrit>

10. Burim interneti: https://www.nato.int/cps/en/natohq/news_174589.htm

11. Burim interneti: <https://www.un.org/sg/en/content/sg/statement/2019-02-13/statement-attributable-the-spokesman-for-the-secretary-general-prespa-agreement>